

**OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE GROUP SH.A.
DEPARTAMENTIT TË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E PROKURIMEVE**

Tiranë, më 18.03.2025

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË
ANKIMIT**

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik: “INFOTEAM srl” Dege e Shoqërisë së Huaj, me adresë, Njësia Bashkiake nr.9, Rruga e Bogdaneve, Pallati. 15, Hyrja 7, ap.4, Kodi postar 1003, Tirane, me Nr. NIPT L62405005G.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☒ **JO** ☐

Referuar Akt – Marreveshjes date 07.02.2025 “Per mbështetje me punonjes”, OE: “INFOTEAM srl”
Dege e Shoqërisë së Huaj parashtron se oferten e saj e mbështet në kapacitete tekniko – profesionale të shoqërisë “Atom” sh.p.k.

- “Atom” sh.p.k. me seli në Tiranë, Njësia nr. 10, Rruga “Islam Alla”, Pallati nr. 56, kati 1 –re, me nr. NIPT L22203042N

Tipi i Kontratës: Shërbime

Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur shërbime mbi kufirin e lartë monetar”.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-34890-12-30-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Implementimi dhe Investimi në një zgjidhje të konsoliduar për një komunikim të sigurt në distancë”, me afat implementimi 6 (gjashtë) muaj nga nënshkrimi i kontratës, pagtimi 1 vit nga implementimi.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: 07.03.2025

Publikimet e mëparshme: Nuk ka

Buletini i Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: Buletini Nr. 12 datë 10 Mars 2025

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kane marrë pjesë Ofertuesit si mëposhtë me vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik **“BNT Electronics”** shpk, me nr. NIPT J61817047D , me vlere oferte 98,743,500 (Nentëdhjetë e tete milion e shtatëqind e dyzet e tre mijë e pesëqind) leke pa TVSH.
2. Operatoreve Ekonomike: **“INFOTEAM srl”** Dege e Shoqërisë së Huaj, me Numer NIPT L62405005G, me vlere oferte 97,450,000 (Nentëdhjetë e shtatë milion e katërqind e pesëdhjetë mijë) leke pa TVSH.

Nga pjesërmarrësit është skualifikuar Operatorin Ekonomik “BNT Electronics” shpk pasi, nuk përmbush:

Nenin 77 pika 3 “Kërkesat për Kualifikim”, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare.

Nenin 77 pika 4, “Kërkesat për Kualifikim”, në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale.

Nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë”, në lidhje me certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë.

Nenin 83 “Sigurimi i ofertës”

të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”,

dhe

Nenin 41 pika 3, Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve , “Për të provuar përvojën e mëparshme..... dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme”

Nenin 41 pika 4 paragrafet a), Kërkesa të veçanta për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Nenin 43 pika 1,2,3 Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare.,

të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Konkretish, ne Dokumentat Standarte të Tenderit, Shtojca 9, “Kriteret e Perzgjedhjes / Kualifikimit”, Autoriteti Kontraktor, ndër të tjera ka kërkuar dhe pikat si mëposhte:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse (*Administrata tatimore*) dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar (*vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare:

ISO 9001 ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme);

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave / shërbimeve që do të marrë përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

2.3.3. Për njohjen e kapaciteteve tekniko - profesionale dhe për përmbushjen me sukses të kontratës, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi / Distributori i autorizuar, për shitjen e produkteve / shërbimeve nga pika 1 deri në pikën 6 të tabelës përmbledhëse (Preventivitet).

Autorizimi i Prodhuesit / Distributorit të autorizuar të përfshijë të dhëna të plota dhe detaje për kontaktin.

Në rast të paraqitjes së Autorizimeve të kërkuara nga Distributori i Autorizuar respektiv të vërtetohet lidhja ndërmjet Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar.

Per sa mesiper, Operatori Ekonomik “BNT Electronics” shpk, nuk ploteson pikat si mesiper të kërkuara në Dokumentat Standarte të Tenderit, ndaj dhe skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomikë “INFOTEAM srl” Dege e Shoqërisë së Huaj, me adresë, Njësia Bashkiake nr.9, Rruga e Bogdaneve, Pallati. 15, Hyrja 7, ap.4, Kodi postar 1003, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 97,450,000 (Nëntëdhjetë e shtatë milion e katërqind e pesëdhjetë mijë) leke pa TVSH / totali i pikëve të marra 100 është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *OSHEE GROUP sh.a, me adresë Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H. 1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Njësia e Prokurimit*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej _____ (me fjale) leke pa TVSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit: PO ☐ JO ☒